



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 174, datë 16.08.2021

MBI
EMËRIMIN NË DETYRË TË SEKRETARIT TË PËRGGJITHSHEM TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 9, neni 14 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 *Për Sektorin e Energjisë Elektrike* i ndryshuar; nenit 32 të Ligjit Nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil* i ndryshuar; të Kreut IV dhe kreut IX pika 2 të VKM-së Nr. 118, datë 5.3.2014 *Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*; Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 78, Datë 29.04.2020 *Mbi Miratimin e disa ndryshimeve Në Strukturën Organizative Dhe organogramën e Entit Rregullator të Energjisë*; të urdhërit të Kryetarit të ERE-s Nr. 63, datë 15.07.2020 *Mbi pozicionet e punonjësve të ERE-s në vendet e punës sipas strukturës së re; Urdhërit të Kryetarit të ERE-s me Nr. 04*, datë 12.01.2021; nenit 4, pika 3 si dhe nenit 5 dhe nenit 5/1 të *Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të ERE-s*” miratuar me vendimin e Bordit Nr. 199, datë 27.11.2020, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me Nr.112/1-1 Prot, datë 10.08.2021, të përgatitur nga *“Njësia Përgjegjëse për rekrutimin e punonjësve të ERE-s*.

Konstatoi se:

- Me urdhërin e Kryetarit të ERE-s me Nr. 04, datë 12.01.2021 është kërkuar:
 - Përgatitja e procedurës së rekrutimit të stafit teknik të ERE s, në zbatim të Vendimit të Nr. 78, Datë 29.04.2020 *Mbi Miratimin e disa ndryshimeve në Strukturën Organizative dhe Organogramën e Entit Rregullator të Energjisë*; të urdhërit të Kryetarit me Nr. 63, datë 15.07.2020 *Mbi pozicionet e punonjësve të ERE-s në vendet e punës sipas strukturës së re*, si dhe në zbatim të procedurave të Ligjit Nr. 152/2013 *Për Nëpunësin Civil* i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 2 të *Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të ERE-s*, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 199, datë 27.11.2020. Këshilltari i Bordit është ngarkuar me detyrën e përgatitjes së procedurës së rekrutimit sipas këtij urdhëri.
- Me shkresën nr. 19 Prot, datë 27.01.2021 është përgatitur *Informacion mbi procedurat e rekrutimit të stafit të ERE-s*”.

- Me shkresën me Nr.19/1 Prot, datë 28.02.2021 është hartuar *Plani Vjetor i Pranimit në Shërbimin Civil për Entin Rregullator të Energjisë për vitin 2021*.
- Në shkresën me Nr. 19/2 Prot, datë 03.03.2021 është paraqitur *Informacioni mbi përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit*
- Me urdhërin e Kryetarit të ERE-s nr. 25, datë 03.03.2021, u ngrit Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
- Me shkresën Nr. 753 Prot, datë 14.06.2021 i është drejtuar Agjensisë Kombëtare të Punësimit me Kërkesë për publikim për vende të lira.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit ka publikuar në faqen e saj :
 - Njoftimin e shpalljes së procedurës së konkurrimit të hapur për Pranimin në Kategorinë e Lartë Drejtuese për Pozicionin Sekretar i Përgjithshëm në datën 15.06.2021 në orën 12.53
- Me shkresën me Nr. 753/1 Prot, datë 22.06.2021, është paraqitur kërkesa për aplikimin në pozicionin e shpallur për Konkurrim për Pozicionin Sekretar i Përgjithshëm nga z. Elton Radheshi.
- Në urdhërin nr. 25/1, datë 21.07.2021 është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP),
- Njësia Përgjegjëse, bëri shqyrtimin e dosjes së aplikantit të paraqitur në protokollin e ERE-s, në lidhje me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati; Kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe dokumentacionin, mënyrën dhe afatit të dorëzimit.
- Rezultoi se, aplikanti z.Elton Radheshi u kualifikua nga Komisionin i Përhershëm i pranimit, për vazhdimin e procedurës së konkurrimit;
 - Me shkresën me Nr. 753/2 Prot, datë 27.07.2021 iu dërgua për publikim Shërbimit Kombëtar të Punësimit,
 - Testi me shkrim do të realizohet në datën 28.07.2021 ora 11.00 pranë zyrave të ERE-s
 - Shërbimi Kombëtar i Punësimit e ka publikuar këtë njoftim në faqen zyrtare në datën 27.07.2021 ora 5.27 (pm),
 - Provimi u realizua në datë 28.07.2021, ora 11.00 pranë zyrave të ERE-s.
- Në përfundim të testimit me shkrim dhe me gojë, sipas tabelave të vlerësimit nga secili anëtar të Komitetit të Përhershëm të Pranimit (i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të ERE-s Nr. 25/1, datë 21.07.2021) u hartua Raporti Përfundimtar i Vlerësimit me Nr. 109/1, datë 28.07.2021 për vlerësimin e pozicionit Sekretar i Përgjithshëm.
- Sipas Raportit Përfundimtar të Vlerësimit rezultoi si kandidat fitues, z. Elton Radheshi, i vlerësuar nga KPP me 98,2 pikë .
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) në vendimin e tij me Nr. 2, datë 30.07.2021 vendosi:
 - *Përzgjedhjen* e z. Elton Radheshi, si kandidat fitues për pozicionin konkurses Sekretar i Përgjithshëm në Entin Rregullator të Energjisë.
- Ky vendim u publikua në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në datën 04.08.2021
- Në nenin 5/1 të Rregullores së brendshme e organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë citohet se:

- *pas kryerjes së fazës së konkurrimit, vendimi për emërimin dhe konfirmimin në detyrë, apo lirim, merret nga titullari sipas përcaktimeve në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërsa emërimi dhe lirimi nga detyra i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltarit të Bordit, bëhet me Vendim të Bordit të ERE.*
- Pika 2 e Kreut IX të VKM-s Nr. 118, datë 5.3.2014, *Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së citon se:*
 - *KPP-ja, për institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, njofton brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e rezultateve, njësinë përgjegjëse për fituesit dhe renditjen e tyre sipas pikëve. Njësia përgjegjëse, brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijani, nxjerr aktin e emërimit, në bazë të propozimit për përzgjedhjen e kandidatit/kandidatëve nga eprori direkt.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Emërimin në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm pranë Entit Rregullator të Energjisë, të z. Elton B. Radheshi, sipas vendimit të Komisionit të Përhershëm të Pranimit, nr. 2, datë 30.07.2021 dhe në përputhje me procedurat e neni 23 të ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar në Vendimin Nr. 243, dt. 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, Për Pranimin, lëvizjen, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” pika 19, Kreu IV i ndryshuar.
2. Njësia Përgjegjëse, ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.